

**Vendim nr. 69, datë 18.06.2020**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Vitore Tusha,	Anëtare e Gjykatës Kushtetuese
Marsida Xhaferllari,	Anëtare e “ “
Elsa Toska,	Anëtare e “ “

në datën 18.06.2020 mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr. 69 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** **EMILJANOSHULLAZI**

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 29, datë 21.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 15, 17, 18, 27, 28, 42, 43, 131, pika 1, shkronjat “c” dhe “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1 dhe neni 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj); nenet 28, 29, 30 dhe 45, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

1. Çështja penale në ngarkim të kërkuesit dhe disa të pandehurve të tjerë, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1, 28/4, 238, 333/a dhe 334 të Kodit

Penal, është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda në datën 13.12.2018. Me vendimin nr.286, datë 18.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj) ka vendosur krijimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GjPAKKO), e cila ka zëvendësuar Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

2. Në datën 23.12.2019, në GjPAKKO, është zhvilluar seanca gjyqësore për çështjen penale të sipërpërmendur. Në këtë seancë, kryesuesja u ka bërë me dije palëve ndërgjyqëse faktin se çështja penale në shqyrtim ka pësuar ndryshime për sa i përket numërtimit të saj, si rrjedhojë e pushimit të funksionimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe krijimit të GjPAKKO-së. Më tej, në datat 06.01.2020 dhe 20.01.2020 seancat gjyqësore nuk janë çelur, por është caktuar vetëm data e seancës së radhës.

3. Trupa gjykuese përbërë nga tre gjyqtarë për gjykimin e çështjes së kërkuesit përbëhet nga relatorja A.B., e cila është gjyqtare e GjPAKKO-së, si dhe gjyqtarët E.T. dhe A.K. që janë caktuar nga KLGj-ja me vendimin nr. 29, datë 21.01.2020 “Për gjyqtarët e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të caktuar në çështje të veçanta në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, e cila, ndër të tjera, ka vendosur: *“Gjyqtarët e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, të caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, vazhdojnë të shqyrtojnë çdo kërkesë procedurale që lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të të pandehurit/eve, në çështjet e veçanta në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, si më poshtë: [...]7. Gjyqtarët E.T. dhe A.K., respektivisht të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurve Emiljano Shullazi etj., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1 dhe 28/4, 238 dhe 28/4, 152, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krime të Rënda).”*

4. Referuar vendimit të sipërcituar të KLGj-së, rezulton se dy gjyqtarët janë caktuar për të plotësuar trupin gjykues për gjykimin e çështjes dhe nuk janë gjyqtarë të emëruar pranë GjPAKKO-së. Sipas dokumenteve që shoqërojnë kërkesën, vërehet se çështja në ngarkim të kërkuesit është ende në shqyrtim pranë GjPAKKO-së.

5. Kërkuesi, duke pretenduar se jemi përpara krijimit të një gjykate të re, ka paraqitur pranë GjPAKKO-së, kërkesën me objekt “Humbje e fuqisë së masës të sigurimit”, e cila nuk është pranuar nga gjykata.

**6. Kërkuesi**, duke pretenduar se vendimi i KLGj-së nr.29/2020 është marrë në shkelje të Kushtetutës, nëpërmjet ankimit kushtetues individual, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e tij, me argumentet si vijojnë:

6.1. Është cenuar *e drejta për liri dhe siguri personale*, e garantuar nga nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNj-së, pasi KLGj-ja ka imponuar formimin e trupës gjyquese në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin. Në këtë mënyrë kërkuessit i është hequr liria, duke u mbajtur në paraburgim, pa u respektuar procedurat e përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji.

6.2. Është cenuar parimi i *gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi gjykata që ka shqyrtuar kërkesën për vleftësimin e masës së sigurimit për shkak të transferimit të çështjes, nuk mund të konsiderohet një gjykatë e caktuar me ligj, për sa kohë dy nga tre anëtarët e trupit gjyqes janë caktuar në mënyrë antikushtetuese dhe të kundërligjshme.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuessit

7. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë. Kolegji rithekson se edhe pas ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr.76/2016, qëllimi i nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, rregulli i shterimit të të gjitha mjeteve juridike efektive, është të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese. Rregulli i shterimit të mjeteve të ankimit efektiv në gjykatat e zakonshme përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit).

8. Gjithashtu edhe neni 71 i ligjit nr. 8577/2000, parashikon: “*Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor*

*ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji.”.*

9. Për sa më lart, Gjykata Kushtetuese gjatë kontrollit kushtetues, përmes ankimit kushtetues individual, vlerëson kërkesat e individit të lidhura me procesin e rregullt ligjor procedural, por edhe të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të pretenduara si të cenuara nga çdo akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor.

10. Kolegji vëren se në çdo rast ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret paraprake të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës, llojin e pasojave negative të pësuar, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kjo Gjykatë ka një jurisprudencë të pasur dhe konstante ndër vite në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës për sa i përket faktit që shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesipara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimet nr. 31 datë 25.05.2015; nr. 17, datë 16.05.2011; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar drejtpërdrejt kësaj Gjykate për konstatimin e shkeljeve kushtetuese për cenimin e standardit të “gjykatës së caktuar me ligj”, si dhe heqjes së lirisë në kundërshtim me Kushtetutën, të pretenduara si të cenuara nga vendimi nr. 29/2020 i KLGj-së. Në rrethana të tilla, është në kompetencën Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë, sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shteruar ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara.

13. Kolegji vlerëson se pretendimet që kërkuesi ka ngritur para Gjykatës Kushtetuese nuk janë të tilla që t’i shmangen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi ato mund të parashtrihen në gjykatat më të lartame anë të rekursit. Kolegji rithekson se e drejta për proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe pretendimet për “gjykatën e caktuar me ligj”, garantohet përgjatë një procesi ligjor ose gjyqësor, në funksion të rezultatit përfundimtar.

14. Në vështrim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për aq kohë sa ai nuk i ka shteruar pretendimet e tij në procedurat gjyqësore brenda sistemit gjyqësor penal.

15. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit se akti i KLGj-së, objekt i kërkesës, është një akt me efekt të përgjithshëm, i cili i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës Kushtetuese për

pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe në nenin 100, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e sistemit të drejtësisë” (ligji nr. 115/2016), Kolegji vëren se ky vendimka një objekt konkret dhe u drejtohet subjekteve individualisht të përcaktuara. Po ashtu, efekti i këtij vendimi është të plotësojë përbërjen e trupit gjykues për të gjykuar çështjen penale të kërkuesit dhe brenda këtij gjykimi kërkuesit i jepet mundësia për të ushtruar të gjitha kërkesat procedurale, duke i dhënë këtij vendimi natyrë shteruese në zbatimin e tij, brenda gjyqimit të çështjes së tij. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky vendim i KLGj-së nuk është një akt me efekt të përgjithshëm.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së tij, për rrjedhojë çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.